



Dita Ndërkombëtare e Konservimit të Energjisë:
10 rekomandime për ndryshim politikash që INDEP propozon



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Hyrje

Prodhimi i energjisë në Kosovë ende mbështetet fortë në resursin natyror të qymyrit. Pak përpjekje janë bërë nga ana e Kosovës drejt plotësimit të objektivave dhe obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Integrimi i saj në mekanizma ndërkombëtar dhe tregut të gjerë të energjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndër marrë hapa të menjëhershëm dhe konkret drejt stabilizimit të këtij sektori dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për mirëqenien e shoqërisë kosovare. Edhe pse tashmë ky sektor ka kohë që është me prioritet në agjendën e Qeverisë, ka akoma mjaft punë për tu bërë në mënyrë që sektori i energjisë të jetë në hap me trendet globale dhe rrugës drejt dekarbonizimit, siç janë promovimi i burimeve të ripërtëritshme (solare dhe erës) dhe efijencës së energjisë (në ndërtesa, pajisje, sektorin e transportit, industrisë etj.)

Në Ditën Ndërkombëtare të Konservimit të Energjisë, me synim rritjen e vetëdijesimit të përdorimit racional të energjisë, si dhe promovimit të burimeve të ripërtëritshme, Instituti për Politika Zhvillimore propozon dhjetë (10) masat që do të ndikonin drejtpërdrejtë në stabilizimin e sektorit, uljen e kostove qoftë financiare apo mjedisore, rritjen e sigurisë energjetike, dhe përmirësimi i mirëqenies sociale.



1. Transformim i sistemit energjetik

Përderisa Kosova po favorizon investimet e dëmshme të bazuara në përdorimin e qymyrit, ajo do të duhej të hartonte një Plan Kombëtar për Transformimin e Sistemit Energjetik deri në vitin 2050. Plani kombëtar do të ishte në përputhje me përkushtimin e Bashkimit Evropian (BE) për derkarbonizimin e plotë deri në 2050. Për Kosovën kjo është ekonomikisht e përshtatshme dhe mjaftë e mirëseardhur për ambientin, sidomos për përmirësimin e shëndetit publik dhe mirëqenies në përgjithësi. Për më tepër, transformimi i sistemit energjetik do të mundësonte krijimin e vendeve të reja të punës të gjelbërta të cilat do të kontribuonin në rritjen e ekonomisë vendore.



2. Burimet e shpërndara të energjisë dhe rezervat energjetike virtuale

Së fundmi në nivel shkencor mbi sektorin e energjisë, globalisht, flitet mjaftë për rezervat energjetike virtuale. Energjia virtuale përfshinë burimet e ripërtëritshme, si ato solare, erës, ujit, dhe biomasës. Burimet e shpërndara të energjisë kanë fituar vëmendje të madhe për shkak të mundësisë që ato japin për t'iu larguar prodhimit të energjisë elektrike nga lëndët fosile. Për më shumë burimet e shpërndara të energjisë ndihmojnë në rritjen e sigurisë dhe mbështetjes në rrjet, duke e bërë këtë të fundit më të fuqishëm në raport me dështimet e mundshme. Gjithashtu, ky sistem eliminon ndjeshëm humbjet teknike në rrjet, si dhe ndotësit që vijnë kryesisht nga prodhuesit e energjisë me lëndë djegëse. Për shkak se në këtë sistem ka furnizues të numërt nga të cilët mundet konsumatori fundor të furnizohet me energji, kjo do t'i fuqizonte ata të fundit akoma më shumë.



3. Promovimi i efiçencës së energjisë

Kosovarët përdorin energji për metër katror (m^2) pothuaj dyfish sa qytetarët e Bashkimit Evropian. Rrjedhimisht, potenciali për rritjen e performancës energjetike të objekteve në sektorin publik, rezidencial dhe industrial është tejet i madh. Një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve ekonomike do të nxiteshin duke e trajtuar efiçencën si burim të energjisë dhe politikat e nxitjes së efiçencës si prioritet shtetëror. Fondi i krijuar i Efiçencës së Energjisë, duhet të hartojë një listë të incentivave financiare dhe fiskale si për materialet efiçente ashtu edhe për produktet. Në të njëjtën kohë, MA, MPMS dhe MZHE duhet të bashkërendojnë aktivitetet që të përgatisin kuadro profesionale të përgatitura për tregun e punës që ndërlidhet me investimet në efiçencë.



4. Stimulimi për përdorim të burimeve të ripërtëritshme

Një detyrë tjetër e politik-bërësve për të promovuar energjinë e gjelbërt është edhe gjetja e mënyrave që stimulojnë ekonomitë familjare dhe bizneset të përdorin burimet e energjisë së ripërtëritshme. Këto mënyra mund të përfshijnë inkurajimin e konsumatorëve të ndrojnë shprehitë e blerjes nga produkteve joefiçente, qoftë edhe duke rritur çmimet e këtyre produkteve në krahasim me ato në dobi të mjedisit. Gjithashtu, mund të draftohen rregullore të cilat i'u imponohen prodhuesve në mënyrë që të ushtrojnë praktikën e prodhimit të tyre. Përdorimi i këtyre burimeve do të rriste ndjeshëm të ardhurat e ekonomive familjare dhe bizneseve. Krahas përfitimeve materiale, kjo do të ndikonte pozitivisht në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit publik, furnizim më të sigurtë të energjisë elektrike dhe çmime stabile. Për bizneset, kalimi në përdorim të BRRE-ve do të fuqizonte brendin akoma më shumë dhe do të rriste besimin e konsumatorëve ndaj kompanisë.



5. Liberalizimi dhe integrimi i tregut

Një ndër hapat kryesor për krijimin e një sektori energjetik stabil dhe të sigurtë është liberalizimi dhe integrimi i tregut të energjisë. Përparësitë që vijnë me liberalizim të tregut janë rritja e konkurrencës në treg, sinjalizim transparent i çmimeve, diversifikimi i burimeve të prodhimit të energjisë, eliminimin e furnizimit të tepërt duke mundësuar kështu shfrytëzimin racional të energjisë, përgjigjja e shpejtë e kërkesave të energjisë dhe përgjithësisht siguria e rrjetit të energjisë. Duke rritur nivelin e sinjalizimit të çmimeve dhe mbështetur kompanitë që operojnë me efikasitet, qeveria do ta kishte më të lehtë të reduktojë nivelin e emisioneve CO₂ që lirohen nga prodhimi i energjisë të bazuar në lëndë djegëse dhe kështu të mbrojnë mjedisin për shoqërinë në përgjithësi.



6. Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së Energjisë dhe Ndryshimeve Klimatike

Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019 – 2028 duhet të identifikojë saktë problemet mjedisore me të cilat Kosova po përballet, si dhe të definojë sa më mirë plani i veprimit drejt zbutjes së këtyre problemeve mjedisore. Gjithashtu kjo strategji duhet të integrohet me Strategjinë e Energjisë si një dokument i vetëm në linjë me udhëzimet e Bashkimit Evropian. Ende nuk është ndërmarrë ndonjë hap drejt përmirësimit të përdorimit racional të resurseve natyrore. Raporti i Progresit i përgatitur nga BE-ja thekson se Kosova ka nevojë urgjente për përmirësimin e standardeve të emetimeve për vetura, kualitet të karburanteve, depozitimi gjeologjik i CO₂, përdorimit të tokës, pyllëzimit, substancave që zvogëlojnë ozonin dhe gazrave të fluoruar.



7. Sektori i transportit


Çdo mjet i transportit është shfrytëzues i energjisë në një mënyrë ose tjetër. Kur flasim për sektorin e transportit në relacion me efikasitetin e energjisë vëmë fokus të veçantë në sigurinë energjetike, performancën e tyre dhe nivelin e konsumimit të lëndës djegëse, kostot e sektorit, dhe efektet e lirimt të CO₂ në mjedis, për shkak që ky sektor mbështetet jashtzakonisht në lëndë që prodhojnë gazra serrë.

Qeveria duhet të prioritetizojë ndryshimin e vjetërsisë dhe performancës mjedisore të veturave që qarkullojnë në Kosovë. Përmes politikave fiskale duhet të ulët kostoja e importit të veturave që ndotin mjedisin më pak, të tilla si veturat hibride dhe elektrike si dhe veturat që plotësojnë kriterin Euro 5 dhe Euro 6. Politikat e transportit duhet të nxisin dekurajimin e përdorimit të veturave duke rritur kualitetin dhe funksionalitetin e transportit publik dhe duke nxitur përdorimin e biçikletave, udhëtimet e përbashkëta të udhëtarëve etj.



8. Fuqizimi i institucioneve e pavarura që sigurojnë mbrojtjen e konsumatorit

Një treg konkurrues energjetik nuk mund të jetë i tillë pa pasur present në sektor institucione të pavarura rregullative të këtij sektori. Institucionet në fjalë nuk duhet të anojnë as nga Qeveria e as nga industria. Për më tepër, mbrojtja e konsumatorit mbete komponent kyçe në reformat rregullative të institucioneve të pavarura në sektorin e energjisë. Prandaj, fuqizimi i kësaj komponente brenda institucioneve të pavarura është thelbësore. Kjo rrjedh edhe nga paketa e tretë e legjislaturës së BE-së e cila në lidhje me institucionet e pavarura thekson se ato duhet të garantojnë që konsumatorët fundor të energjisë të gëzojnë mbrojtje të tyre me standarde të larta. Komisioni për ndihmën shtetërore duhet të funksionalizohet dhe të sigurojë që intervenimi i shtetit nuk çrregullon tregun. Ky Komision duhet të sigurojë që nuk ka favorizim të ndërmarrjeve të caktuara në treg nga ana e shtetit dhe se konkurrenca mbrohet.



9. Arsimi, inovacioni dhe vetëdijesimi

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të zhvillojë programe të trajnimit të punonjësve për të punuar me materiale efikente. Kurrikulat e universiteteve publike duhet të përfshijnë më shumë programe të studimeve në fushat që përfshijnë menaxhimin e sistemeve energjetike, efikencën e energjisë në prodhim dhe konsum si dhe të përfshijë efikencën e energjisë si lëndë obligative në kurrikulat e programeve inxhinierike, të politikave publike, ndërtimtarisë dhe arkitekturës dhe të fushës së menaxhmentit. Gjithashtu, kurrikulat e qendrave të aftësimit profesional duhet të përfshijnë efikencën e energjisë në programet e konstruksioneve dhe aftësimin të ndërtimtarëve për punën me materiale efikente. Duhet t’u jepet përparësi programeve të aftësimin për instalim të mbulesave të shtëpive, izolim të dyshemeve, dritareve dhe çative dhe të instalimit të pajisjeve efikente të ngrohjes.



10. Të dhëna statistikore të sektorit

Kosovës ende i mungon një sistem i integruar i statistikave të fushës së energjisë. Kjo përfshinë statistika të shpenzimit të energjisë për të gjitha sektorët, pra një shkallëzim të konsumit final për të gjithë sektorët në kohë reale. Përveç kësaj, nevojiten statistika për nënsektorë dhe një disagregim të plotë të të dhënave. Gjithashtu, në kohë reale duhen procesuar të dhëna mbi intensitetin energjetik tek përdoruesit e fundit për të gjitha sektorët dhe burimet e energjisë. Vetëm me një sistem efikas të statistikave mund të matet suksesi dhe të projektohen politika për të ardhmen në fushën e efijencës.



Mbështetur nga:



‘Ky propozim politikash është në kuadër të programit për Zhvillim të Qëndrueshëm, të financuar nga Rockefeller Brother Foundation (RBF). Propozimet e paraqitura këtu nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Rockefeller Brother Foundation.’